

RAPORT

Vlerësimi i kapaciteteve
të koordinatorëve të së drejtës
së informimit dhe njoftimit
dhe konsultimit publik

Maj 2018



HARTUAN RAPORTIN:

MIGENA KONDO

Eksperte ligjore

ELDA KAPLLANI

Eksperte staticiene

ARDITA SHEHAJ

Drejtoreshë e Drejtorisë së Informimit, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe të Dhënave Personale

ERSIDA SEFA

Menaxhere programi, Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, Soros



FONDACIONI SHOQËRIA
E HAPUR PËR SHQIPËRINË

në bashkëpunim me



KOMISIONERI PËR TË DREJTËN
E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE

RAPORT “VLERËSIMI I KAPACITETEVE TË KOORDINATORËVE TË SË DREJTËS SË INFORMIMIT DHE NJOFTIMIT DHE KONSULTIMIT PUBLIK”

Adresa

Rr. Qemal Stafa, Pallati 120/2, Tirana, Albania

Tel: +355 4 22 34 621/ 22 34 223/ 22 35 856

Fax: +355 4 22 35 855

E-mail: info@osfa.al

www.osfa.al

TABELA E PËRMBAJTJES:

HYRJE	4
ANALIZË E SITUATËS AKTUALE	6
QËLLIMI I RAPORTIT	11
METODOLOGJIA	13
ASPEKTI LIGJOR \ INSTITUCIONAL	17
ASPEKTI ORGANIZATIV	23
ASPEKTI INDIVIDUAL.....	30
REKOMANDIME	36

Transparenca e veprimtarisë së organeve publike dhe pjesëmarrja qytetare në vendimmarrjen e tyre, janë garanci për mirëqeverisje, politika publike cilësore dhe organe shtetërore të përgjegjshme përpara qytetarëve.

I. HYRJJE

Dy komponentët më të rëndësishëm të një qeverisje të hapur dhe gjithëpërfshirëse janë e drejta e informimit dhe pjesëmarrja e qytetarëve në proceset vendimmarrëse publike. E drejta e informimit, si një mjet i fuqishëm për të monitoruar qeverinë dhe luftuar korrupsionin, dhe e drejta për t'u njohur dhe për të kontribuar në formulimin e politikave publike janë dy anë të së njëjtës medalje, pasi ato jo vetëm shprehin thelbin e një qeverisje demokratike, por shpesh zbatimi i tyre në praktikë është mjaft i ndërvarur. Mungesa e aksesit në informacionin publik e privon publikun nga mundësia reale për të kontrolluar veprimtarinë e qeverisë dhe çënon marrjen e vendimeve në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe demokratike. Këto ligje quhen ndryshe edhe "sunshine laws" për shkak se ato janë mekanizmi që e lejon publikun e gjerë të hedhë dritë mbi skutat e errëta të aparatit shtetëror.

Shqipëria ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm në drejtim të miratimit të një kuadri ligjor të avancuar për të drejtën e informimit dhe njoftimin dhe konsultimin publik, qoftë në nivel kushtetues¹, ashtu edhe në nivel ligjor e nënligjor. Prej afro katër vitesh janë në zbatim dy ligje të rëndësishme, ligji Nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" dhe ligji nr. 146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik". Përveç kësaj, vendi ynë ka nënshkruar një sërë aktesh ndërkombëtare që parashikojnë lirinë e shprehjes si një të drejtë themelore të njeriut, si dhe është anëtar i platformave ndërkombëtare që promovojnë qeverisjen e hapur dhe transparente².

Ligji 119/2014 "Për të drejtën e informimit" është në përputhje me standardet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare dhe evropiane dhe parashikon mekanizma shtesë për të lehtësuar zbatimin e tij në praktikë dhe për të promovuar aksesin në informacionin publik.

Kështu, ligji bën një përkufizim të gjerë të "informacionit" dhe "organeve publike" që janë subjekt i tij, dhe i njuh të drejtën për informim çdo individ, shtetasi shqiptar, të huaj apo pa shtetësi, në përputhje me parimin se kjo e drejtë është universale. Heshtja konsiderohet si mohim i së drejtës së informimit, duke i detyruar organet publike të jenë aktive ndaj qytetarëve. Përveç kësaj, ligji parashikon detyrimin e autoritetit publik për të publikuar informacione pa kërkesë, nëpërmjet Programeve Institucionale të Transparencës. E drejta për të kërkuar informacion pa qenë nevoja për të shpjeguar motivet përmbush qëllimin e vetë ligjit, i cili ka dy dimensione, marrja e informacionit në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë, por edhe formimi i pikëpamjeve për gjendjen e shtetit dhe të shoqërisë. Kjo e fundit është e lidhur ngushtë edhe me mundësinë e publikut për t'u përfshirë aktivisht në procesin e vendimmarrjes publike.

1. Kushtetuta parashikon lirinë e shprehjes (neni 22) dhe të drejtën e informimit (neni 23) si të drejta kushtetuese të çdo individ.

2. Shqipëria ka nënshkruar Konventën e OKB për të Drejtat e Njeriut, Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Konventën e Aarhusit, Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike si dhe është anëtare e Partneritetit për Qeverisjen e Hapur (Open Government Partnership- OGP) që prej vitit 2011.

Lidhur me mënyrën e kërkimit dhe marrjes së informacionit, ligji parashikon një larmi mjetesh përfshirë mediumin elektronik dhe të drejtën e qytetarit për të zgjedhur formën e marrjes së këtij informacioni. Ligji parashikon se si rregull informacioni jepet pa pagesë dhe në raste të justifikuar kundrejt një tarife të orientuar në kosto, që është në përputhje me parimin ndërkombëtar që tarifat nuk duhet të jenë një barrierë për realizimin në praktikë të së drejtës së informimit.

Ligji i ri parashikon afate të shpejta për dhënien e informacionit, në përputhje me standartin ndërkombëtar se kërkesat për informacion duhet të procesohen me shpejtësi dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi. Ligji parashikon gjithashtu edhe mjetet ligjore përkatëse për trajtimin e ankesave në rast të cënimit të së drejtës për informim si dhe shkeljet dhe sanksionet përkatëse administrative, duke parashikuar përveç ankimit administrativ edhe të drejtën për ankim gjyqësor. Kufizimet për të drejtën e informimit janë në përputhje me standardet ndërkombëtare që parashikojnë se kufizimi i kësaj të drejte bëhet në raste specifike të përcaktuara qartësisht në ligj, që i nënshtrohen në çdo rast testit të proporcionalitetit ndërmjet "dëmit potencial që mund të shkaktohet nga dhënia e informacionit" dhe "interesit të lartë publik". Gjithashtu, një garanci më shumë për zbatimin me efektivitet të këtij ligjit është parashikimi i zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si institucioni përgjegjës për monitorimin e tij.

Një risi e rëndësishme e ligjit është krijimi i një figure të re, koordinatorit të së drejtës së informimit. Organet publike duhet të parashikojnë sisteme të brendshme të hapura, të aksesueshme për të siguruar të drejtën e publikut për të marrë informacion. Organet publike duhet të caktojnë një person të brendshëm që është përgjegjës për shqyrtimin e kërkesave dhe sigurimin e respektimit të ligjit nga ana e institucionit.

Ligji nr. 146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik", parashikon rregullat procedurale për njoftimin dhe konsultimin publik si një nga garancitë më të rëndësishme të pjesëmarrjes së qytetarëve në hartimin e legjislacionit. Ligji parashikon standarde të qarta sa i takon fushës së projektakteve që i nënshtrohen njoftimit dhe konsultimit publik dhe mbështetet tek parimet e transparencës, efektshmërisë së vendimmarrjes së organeve publike, dhe përgjegjësisë së tyre ndaj palëve të interesuara. Ligji parashikon se çdokush mund të përfshihet në procesin e konsultimit publik, gjë e cila e bën procesin gjithëpërfshirës dhe mjaft të hapur e demokratik. Ai parashikon të drejtën e palëve të interesuara, jo vetëm për t'u informuar dhe kontribuar në procesin e hartimit dhe miratimit të projektakteve, por edhe të drejtën për të kërkuar fillimin e procedurës për hartimin dhe miratimit e një projektakti, sipas planit vjetor të vendimmarrjes së institucionit.

Nga ana tjetër, ligji parashikon një sërë detyrash për organin publik, mospërbushja e të cilave pengon zbatimin korrekt në praktikë të ligjit, duke e bërë procesin e vendimmarrjes të mbyllur dhe jashtë kontrollit të publikut dhe grupeve të interesit. Kështu, disa hapa kyçe të parashikuara nga ligji përfshijnë publikimin e çdo projekt-akti në regjistrin elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike, dhënien e informacionit të plotë për të gjitha fazat e njoftimit dhe konsultimit publik, publikimin në programin institucional të transparencës të planeve vjetore të vendimmarrjes, publikimin e raporteve vjetore të transparencës për procesin e vendimmarrjes, zhvillimin e takimeve publike për projektakte të rëndësishme, mbledhjen dhe shqyrtimin e komenteve dhe rekomandimeve dhe transparencën e vendimmarrjes lidhur me to. Gjithashtu, ashtu si dhe ligji "Për të drejtën e informimit", ky ligj parashikon figurën e koordinatorit për njoftimin dhe konsultimin publik si personi përgjegjës për mbarëvajtjen e procesit të njoftimit dhe konsultimit publik.

II. ANALIZË E SITUATËS AKTUALE

Megjithë standardet e larta që parashikojnë këto dy ligje, pas afro katër vitesh pas miratimit, ende zbatim i tyre në praktikë shënon nivele jo të kënaqshme. Institucionet publike shfaqin ende mangësi sa i takon njohjes dhe zbatimit të duhur të këtij kuadri ligjor.

Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2018, konstaton se përsa i përket pjesëmarrjes publike në vendimmarrjen vendore, ka pasur progres të mëtjshëm në fushën e aksesit në informacion: një numër në rritje bashkish kanë siguruar një akses më të lartë në informacionin publik dhe kanë caktuar një koordinator lokal përgjegjës për të drejtën për informim³. Korniza institucionale për pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrjen vendore, sidomos në procesin e buxhetimit, ka nevojë të forcohet për të gjitha bashkitë. Raporti konstaton gjithashtu se pavarësisht se e drejta e publikut për t'u përfshirë në procesin legjislativ është e rregulluar me ligj, kjo nuk zbatohet plotësisht në praktikë. Portali elektronik për konsultimet publike i ndërtuar në vitin 2017, ende nuk përdoret nga të gjitha ministratë⁴.

Gjithashtu, Raporti i Komisionit Evropian shprehet se zbatim i ligjit "Për të drejtën e informimit" ka shënuar mangësi. Konstatohet se ka një numër në rritje të autoriteteve publike që kanë miratuar programet e tyre të transparencës. Pavarësisht, sipas Raport-Progressit nevojiten më shumë përpjekje për të nxitur transparencën proaktive të institucioneve publike⁵. Akses i kontratat e prokurimit, auditimet dhe pagat e zyrtarëve duhet të jetë më i lartë. Vendimet e Komisionerit për të Drejtën e Informimit nuk janë të detyrueshme për zyrtarët e administratës publike.

Gjithashtu, në vitin 2016, Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë realizoi një vlerësim të progresit të zbatimit në praktikë të ligjit Nr. 146/2014 "Për njoftimin konsultimin publik"⁶ tek institucionet qendrore. Gjetjet e studimit treguan se institucionet qendrore shfaqin ende probleme serioze për zbatimin siç duhet të ligjit "Për të drejtën e informimit" dhe të kuptuarit e konceptit të transparencës proaktive. Kështu, një pjesë e mirë e tyre nuk kanë respektuar afatet për dhënien e informacionit dhe informacioni i dhënë nuk ishte i plotë.

Lidhur me njoftimin dhe konsultimin publik, studimi i Fondacionit konstatoi një sërë mangësish që kishin të bënin si me mosfunksionimin e regjistrat elektronik për njoftimin dhe konsultimin publik, mosaktimin e koordinatorëve për njoftimin dhe konsultimin publik në të gjitha institucionet qendrore, aplikimin e procesit të njoftimit dhe konsultimit publik mbi baza selektive, mospublikimin e programeve vjetore të procesit të vendimmarrjes, dhe mangësi në hartimin dhe publikimin e raportit vjetor për transparencën në procesin e vendimmarrjes.

Sigurisht që, zbatim i duhur i kërkesave të këtyre dy ligjeve kërkon më shumë kapacitete njerëzore dhe institucionale, për t'i bërë këto të drejta sa më efektive në shërbim të qëllimit përfundimtar të rritjes së transparencës së autoriteteve publike dhe pjesëmarrjes qytetare në politikë-bërje dhe vendimmarrje. Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrotjtjes së të Dhënave Personale dhe Fondacioni

3. Raport progresi i BE-së për Shqipërinë 2018, faqe 11.

4. Raport progresi i BE-së për Shqipërinë 2018, faqe 12.

5. Raport progresi i BE-së për Shqipërinë 2018, faqe 15.

6. http://www.osfa.al/sites/default/files/sfidat_e_zbatimit_ne_praktike_te_ligjit_per_njoftimin_dhe_konsultimin_publik_web.pdf#overlay-context=

Shoqëria e Hapur për Shqipërinë vlerëson se forcimi i statusit të koordinatorit konsiderohet një masë efektive në rritjen e nivelit dhe cilësisë së zbatimit të këtij kadri ligjor. Përveç mjeteve ligjore ankimore dhe sanksioneve administrative në rastin e shkeljes së këtyre të drejtave, këto dy ligje me anë të koordinatorit ofrojnë një mekanizëm shtesë për zbatimin e tyre në praktikë. Koordinatori është nëpunësi publik përgjegjës për bashkërendimin e punës për të garantuar të drejtën e informimit dhe njoftimit dhe konsultimit publik për qytetarët⁷. Ky rol konsiderohet kyç dhe vendimtar në përmbushjen e detyrimeve ndaj qytetarëve që rrjedhin nga këto ligje për organet publike.

Avantazhet e caktimit të koordinatorit

Caktimi i një personi të vetëm për të qenë përgjegjës për bashkërendimin e punës për zbatimin e këtyre ligjeve ka avantazhe në drejtim të rritjes së efikasitetit të zbatimit të transparencës nga ana e organit, lehtësimit të identifikimit të përgjegjësisë në rastin e mosrespektimit të këtyre të drejtave, rritjen e llogaridhënies ndaj qytetarëve, rritjen e kapaciteteve profesionale brenda institucionit në këto fusha nëpërmjet specializimit të këtyre nëpunësve, si dhe ofrimit të një pike kontakti të qartë për çdo institucion. Gjithashtu, koordinatori duhet të ketë edhe një rol proaktiv për promovimin e transparencës së institucionit dhe këshillues ndaj qytetarëve në realizimin e të drejtave të tyre në bazë të këtyre ligjeve. Ai garanton respektimin e afateve ligjore dhe realizimin e të drejtave në praktikë, duke koordinuar punën brenda institucionit ndërmjet hallkave përkatëse që bëjnë të mundur informacionin apo realizimin e procesit të vendimmarrjes me përfshirje qytetare.

Koordinatori për të drejtën e informimit është i ngarkuari kryesor institucional për transparencën e institucionit, pasi ai realizon pjesën më të madhe të detyrave që parashikon ligji "Për të drejtën e informimit". Kështu, koordinatori është përgjegjës për trajtimin e kërkesave për informacion, që përfshin regjistrimin e tyre, sigurimin dhe dhënien e informacionit, identifikimin dhe dërgimin e kërkesës tek organi që e disponon informacionin, komunikimin me kërkuuesin, këshillimin, si dhe rolin e koordinuesit ndërmjet hallkave të institucionit për të siguruar informacion e kërkuar dhe përgatitur arsyetimin e nevojshëm në rast kufizimi të kësaj të drejte. Koordinatori, gjithashtu, është ekskluzivisht përgjegjës për regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve. Përveç kësaj, koordinatori siguron që i gjithë institucioni të përmbushë çdo kërkesë të ligjit "Për të drejtën e informimit", duke mbështetur titullarin në përgjegjësitë e tij/saj individuale dhe pjesët e tjera të institucionit, për çështjet e transparencës. Ligji përveç kompetecave që ka parashikuar për koordinatorët e së drejtës së informimit, ka caktuar përgjegjësitë dhe sanksione përkatëse në rast të mospërmbushjes së tyre.

Ndërsa ligji "Për të drejtën e informimit" përcakton se cilat janë përgjegjësitë specifike të koordinatorit dhe ato të titullarit dhe nëpunësve të tjerë të institucionit, ligji "Për njoftimin dhe konsultimin publik", ia ngarkon detyrimet dhe përgjegjësitë që rrjedhin nga ky ligj "organit publik" si një i tërë, pa specifikuar ndarjen e përgjegjësisë brenda tij. I vetmi detyrim që ligji i ngarkon shprehimisht koordinatorit është ai "...i grumbullimit të komenteve dhe rekomandimeve të marra gjatë procesit të konsultimit në mënyrë të strukturuar dhe transparente" (neni 19, pika 1). Ndërkohë edhe Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 584, datë 28.08.2003 "Për miratimin e rregullores së Këshillit të Ministrave", i ndryshuar në Kreun III "Përgatitja e projektaktit" parashikon se çdo organ duhet të caktojë një punonjës të administratës, përgjegjës për

7. Neni 10 i të dy ligjeve.

hedhjen e të dhënave në regjistrin elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike të projekt-akteve, detyrë që duhet të përfshihet në përshkrimin e punës së personit të caktuar, por pa iu referuar specifikisht koordinatorit për njoftimin dhe konsultimin publik.

Ligji “Për njoftimin dhe konsultimin publik” nuk parashikon sanksione specifike për koordinatorin, por të drejtën e titullarit për marrjen e masave administrative sipas legjislationit për shërbimin civil, ndaj çdo personi përgjegjës për shkeljen e detyrimeve të këtij ligji, përfshirë edhe koordinatorin për njoftimin dhe konsultimin publik. Në interpretim të frymës së ligjit dhe rolit garantues të zbatimit të tij, koordinatori është ai që duhet në praktikë të realizojë të gjithë fazat e njoftimit dhe konsultimit publik, si mbështetës i organeve vendimmarrëse të institucionit, në trajtimin e konsultimit publik. Kjo do të thotë se koordinatori është personi përgjegjës për identifikimin dhe publikimin në regjistrin elektronik të projektakteve që do t’i nënshtrohen njoftimit dhe konsultimit publik në institucion, informacionet mbështetëse, mbledhjen dhe strukturimin e komenteve të publikut, koordinimin e takimeve publike, përgatitjen dhe publikimin e përmbledhjeve që shoqërojnë projektaktet dhe që pasqyrojnë nëse komentet janë pranuar apo refuzuar dhe arsyet e refuzimit, si dhe duhet të bashkëpunojë ngushtësisht me koordinatorin për të drejtën e informimit për të pasqyruar në programin e transparencës planin vjetor të vendimmarrjes, dhe informacione të tjera që lidhen me procesin vendimmarrës (neni 7 i ligjit “Për të drejtën e informimit”). Ai/ajo është personi që duhet të monitorojë respektimin e procedurave dhe afateve që parashikon ligji.


Nga gjetjet e monitorimeve konstatojmë se roli i koordinatorëve të së drejtës së informimit dhe njoftimit dhe konsultimit publik ende nuk realizohet në nivelet e kërkuara nga kuadri ligjor përkatës.

Afro katër vite nga miratimi i këtyre ligjeve, procesi i caktimit të koordinatorëve të njoftimit dhe konsultimit publik nuk ka përfunduar ende. Nga rezultatet e monitorimeve të kryera, rezulton se koordinatorët e të drejtës së informimit janë caktuar pothuajse të gjithë në pushtetin qendror, vendor dhe në institucionet e pavarura, ndërsa koordinatorët e njoftimit dhe konsultimit publik më së shumti janë caktuar vetëm në pushtetin qendror dhe institucionet e pavarura. Në shumicën e rasteve këto dy funksione bashkohen në një nëpunës të vetëm, por ka raste kur janë nëpunës të ndryshëm.

Bazuar në përgjigjet e sondazhit të zhvilluar nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale në bashkëpunim me Fondacionin Shoqëria e Hapur për Shqipërinë rezulton se ka 61 koordinatorë të së drejtës së informimit në pushtetin qendror, 49 në pushtetin vendor, 15 në institucionet e pavarura dhe 12 në drejtoritë e përgjithshme⁸. Ndërsa koordinatorët për njoftimin dhe konsultimin publik, sondazhit i janë përgjigjur 9 koordinatorë nga pushteti qendror dhe 9 të tjerë nga pushteti vendor.

8. Këto të dhëna statistikore janë të vlefshme për periudhën e realizimit të sondazhit, përkatësisht qershor-korrik 2017.

Caktimi i koordinatorëve për të drejtën e informimit dhe njoftimit dhe konsultimit publik



Përveç kësaj, pozita që aktualisht kanë koordinatorët në institucion është e dobët në krahasim me përgjegjësitë dhe detyrat që u ngarkon atyre ligji përkatës për të garantuar zbatimin e tyre. Kjo ka të bëjë si me statusin e tyre ligjor dhe institucional dhe me kapacitetet e tyre profesionale për këtë detyrë.

Aspektet kryesore të problematikave të konstatuara në lidhje me kapacitetet e koordinatorëve përfshijnë:

- **mungesën e një statusi të veçantë brenda institucionit (aspekti ligjor)**, në aspektin e hierarkisë për të pasur akses të drejtpërdrejtë tek strukturat vendimmarrëse dhe teknike, mungesa e incentivave financiare dhe pamjaftueshmëria e kohës së nevojshme për të realizuar detyrat e tyre, mungesa e kriterëve në përzgjedhjen e koordinatorëve dhe më pas në specializimin e tyre si dhe paqëndrueshmëria në detyrë;
- **mungesën e mbështetjes organizative-institucionale për koordinatorët (aspekti institucional)** me anë të rregullave të brendshme institucionale, si rregullore e brendshme e institucionit, urdhra të brendshëm, përshkrimi i punës së koordinatorit, të cilat i sigurojnë akses dhe "pushtet" koordinatorëve tek drejtuesit e lartë dhe strukturat përkatëse të institucionit, përfshirë detyrimin e këtyre të fundit për të bashkëpunuar. Gjithashtu, mungesa e udhëzuesve të brendshëm që zbërthejnë në hapa/ procese konkrete realizimin e detyrave të koordinatorit, përfshirë ndarjen e qartë të detyrave dhe përgjegjësi ndërmjet tij/saj, drejtuesve dhe nëpunësve të tjerë të institucionit, si dhe mungesa e sistemeve të monitorimit dhe vlerësimit të performancës së koordinatorëve, bazuar në objektiva pune konkrete dhe indikatorë të matshëm;

- **ndërgjegjësimin dhe aftësitë profesionale të koordinatorëve (aspekti individual)**, mungesë kapacitetesh profesionale për të bashkërenduar punën brenda institucionit, për shkak se personat e caktuar në këtë rol shpesh nuk kanë formimin arsimor të përshtatshëm dhe përvojën e mjaftueshme brenda administratës publike, nuk kanë marrë trajnimin e duhur dhe të vazhdueshëm për t'u specializuar në këtë fushë, pozicioni që ata mbajnë nuk është i përshtatshëm me rolin e koordinatorit, si dhe mungon një rrjet i koordinatorëve që do të shërbente edhe si një platformë trajnuese për shkëmbimin e përvojave ndërmjet tyre.

Duke pasur parasysh përgjegjësinë që i është ngarkuar koordinatorit nga këto dy ligje për të garantuar realizimin e drejtave të qytetarëve në mënyrë efektive dhe cilësore, nevojiten masa konkrete për të forcuar si statusin e tyre ligjor dhe institucional ashtu edhe kapacitetet e tyre profesionale në fushat komplekse të së drejtës së informimit dhe njoftimit dhe konsultimit publik.

Nëpërmjet këtij raporti synohet të realizohet një vlerësim i kapaciteteve të koordinatorëve të së drejtës së informimit dhe njoftimit dhe konsultimit publik, në tre aspekte kryesore: aspektin ligjor, organizativ dhe individual. Vlerësimi mbulon edhe mangësi të tjera ligjore që e bëjnë të vështirë përmbushjen e detyrave të koordinatorit dhe zbatimin me efikasitet të këtyre ligjeve në praktikë.

Në përfundim të këtij procesi vlerësues, raporti identifikon rekomandime konkrete për forcimin e statusit ligjor, institucional dhe aftësive profesionale të koordinatorëve, të cilat mund të adresohen përmes amendimit të ligjeve përkatëse dhe përmirësimit të procedurave të brendshme të çdo institucioni.

III. QËLLIMI I RAPORTIT

Me synim për të kontribuar në përmirësimin e respektimit të së drejtës së informimit dhe pjesëmarrjes qytetare në proceset vendimmarrëse, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale në bashkëpunim me Fondacionin Shoqëria e Hapur për Shqipërinë ka ndërmarrë nismën për vlerësimin e kapaciteteve të koordinatorëve të së drejtës së informimit dhe njoftimit dhe konsultimit publik. Projekti mbulon periudhën qershor – dhjetor 2017 dhe përfshin në këtë vlerësim pushtetin qendror dhe vendor, institucionet e pavarura dhe drejtoritë e përgjithshme.

Në nivel qendror u përfshin 173 institucione, ndër këto:

- 77 institucione qendrore (duke përfshirë Kryeministrinë, ministritë e linjës dhe institucionet e varësisë),
- 20 institucione të pavarura,
- 15 drejtori të përgjithshme dhe
- 61 bashki.

Vlerësimi i kapaciteteve të koordinatorëve u mbështet në tre dimensione kryesore: mjedisi mundësues (ligjor), mjedisi organizativ (institucional) dhe aspekti individual.

Fusha e vlerësimit

Duke u bazuar në problematikat e konstatuara nga monitorimet e kryera gjatë këtyre viteve të zbatimit të ligjeve, vlerësimi i aspektit ligjor mbulon çështje të tilla si:

- pozita e koordinatorëve në hierarkinë e institucionit,
- natyra e punës që ata kryejnë,
- akti dhe kriteret për caktimin e tyre si koordinator,
- përvoja e punës,
- trajtimi i tyre financiar për shkak të mbajtjes të kësaj detyre,
- reflektimi i kësaj detyre në përshkrimin e tyre të punës,
- koha e mjaftueshme që u vihet atyre në dispozicion për realizimin e kompetencave të koordinatorit e të tjerë elementë të ngjashëm.

Vlerësimi i aspektit institucional mbulon çështje të tilla si:

- aksesimi që koordinatorët kanë tek nëpunësit e niveleve të larta drejtuese dhe vendimmarrëse të institucionit,
- ekzistenca e procedurave të brendshme në institucion për zbatimin e këtyre ligjeve,
- ekzistenca e rregullave të brendshme për koordinimin me degët rajonale të institucionit,
- bashkëpunimi me strukturat e tjera të institucionit,
- ekzistenca e një rrjeti të koordinatorëve,
- vlerësimi i performancës së koordinatorëve me anë të objektivave dhe indikatorëve të performancës.

Vlerësimi i aspektit individual, mbulon çështje të tilla si:

- kualifikimi i koordinatorëve,
- arsimi i tyre dhe trajnimet e marra,
- asistencë ligjore/teknike që i ofrohet atij nga strukturat e tjera të institucionit,
- përvoja e tyre në këtë fushë,
- njohuritë specifike mbi ligjin dhe problematikat që ata hasin gjatë interpretimit të tij,
- aspektet e paqarta lidhur me rolin e koordinatorit dhe
- nevojat për trajnim.

IV. METODOLOGJIA

1. Objektivat e sondazhit

Objektivi i përgjithshëm i sondazhit është vlerësimi i kapaciteteve të koordinatorëve të së drejtës së informimit si dhe koordinatorëve të njoftimit dhe konsultimit publik në lidhje me pozitën e tyre brenda institucionit, burimet dhe infrastrukturën ekzistuese në mbështetje të detyrës së tyre, si dhe aftësitë profesionale.

Objektivat specifike të sondazhit janë:

- Të evidentojë profilin e koordinatorëve të së drejtës së informimit si dhe të njoftimit dhe konsultimit publik;
- Të mbledhë informacion mbi ndryshimet ligjore dhe masat institucionale që mund të merren në lidhje me pozitën e koordinatorëve;
- Të hartojë sugjerime konkrete për forcimin e statusit të tyre.

Vlerësimi për matjen e kapaciteteve profesionale të koordinatorëve të së drejtës së informimit dhe njoftimit dhe konsultimit publik u bë përmes të dhënave të marra nga dy burime kryesore:

- Sondazhi me koordinatorët e të drejtës së informimit dhe të konsultimit publik;
- Grupet e fokusuara me përfaqësues të tjerë të institucioneve të monitoruara.

Për këtë sondazh u përdor një kombinim i qasjes sasiore me atë cilësore. Duke qenë se secila qasje ka avantazhet dhe kufizimet e veta, kombinimi i të dhënave të gjeneruara përmes të dy qasjeve do të theksojë pikat e forta të secilës metodë, duke u kthyer kështu në një burim të besueshëm informacioni për vlerësimin e kapaciteteve profesionale të koordinatorëve. Qasja sasiore, sondazhi, u shfrytëzua për të matur madhësinë e fenomenit dhe rezultateve të tij. Rezultatet e sondazhit lejojnë vëzhgimin e tendencave që ekzistojnë brenda popullatës së "koordinatorëve të informimit dhe konsultimit publik" dhe kryerjen e krahasimeve në këtë nivel.

Ndërsa qasja cilësore, fokus grupet u shfrytëzuan për të kuptuar dhe hedhur dritë mbi fenomenin, duke mundësuar një thellësi më të madhe shpjeguese dhe një të kuptuar më të plotë të çështjes në shqyrtim. Fokus grupet u zhvilluan me përfaqësues të tjerë të institucioneve të monitoruara, përgjithësisht përfaqësues nga drejtoritë juridike, të buxhetit apo dhe të strukturave të tjera që kanë bashkëpunim më të ngushtë me koordinatorët në ushtrimin e kompetencave dhe përgjegjësi të tyre ligjore në këtë fushë. Marrja e opinionit të pjesës tjetër të stafit të institucioneve për punën e koordinatorëve shërbeu për t'i krahasuar ato me gjetjet sasiore të sondazhit.

Analiza sasiore është mbështetur në mbledhjen e të dhënave nëpërmjet hulumtimit të plotë të koordinatorëve për të drejtën e informimit në institucionet qendrore, qeverisjen vendore, institucionet e

pavarura si dhe drejtoritë e përgjithshme. Ndërsa për koordinatorët e njoftimit dhe konsultimit publik, të dhënat u mbledhën nga institucionet pushtetit qendror dhe 12 bashkitë në nivel qarku.

2. Baza e zgjedhjes dhe njësiti e vrojtimit të sondazhit

Sondazhi përdori pyetësorët si instrumentin bazë për kryerjen e këtij vrojtimi. Grupet e synuara të sondazhit ishin:

1. Koordinatorët e së drejtës së informimit, pjesë e institucioneve të pavarura, pushtetit qendror e vendor dhe drejtoritë e përgjithshme, të cilat janë ose jo nëpunës civil;
2. Koordinatorët e njoftimit dhe konsultimit publik, pjesë e institucioneve të pushtetit qendror dhe vendor (në nivel qarku), të cilët janë ose jo nëpunës civil.

Për të mbledhur informacionin e nevojshëm, u përdor teknika e vrojtimit të përgjithshëm statistikor. Vrojtimi i drejtpërdrejtë mbështetet në grumbullimin e të dhënave drejtpërsëdrejti nga persona fizikë nëpërmjet pyetësorëve në "google form". Gjatë përpunimit të të dhënave, kujdes të vecantë iu kushtua ruajtjes së konfidencialitetit. Konfidencialiteti statistikor ka të bëjë me mbrojtjen e të dhënave që lidhen me çdo person që është intervistuar, përgjigjet e të cilëve janë marrë direkt për qëllime statistikore. Prandaj, përpunimi i të dhënave u bë në mënyrë të tillë që të mos të shkelë të drejtën e konfidencialitetit. Kjo nënkupton parandalimin e përdorimit jostatistikor të të dhënave të marra dhe zbulimin e personave, të cilët janë përgjigjur pyetësorit.

3. Madhësia e kampionit

Pyetësori i koordinatorit për të drejtën e informimit u shpërnda në të gjitha institucionet qendrore, institucionet e pavarura, drejtoritë e përgjithshme dhe bashkitë. Më poshtë jepet shpërndarja e pyetësorëve sipas institucioneve.

Tabela 3. Shpërndarja e pyetësorit për koordinatorët e të drejtës së informimit sipas institucioneve:

INSTITUCIONI	FREKUENCA	PËRQINDJE
Pushteti qendror	77	44.5 %
Pushteti vendor	61	35.3 %
Institucionet e pavarura	20	11.6 %
Drejtoritë e Përgjithshme	15	8.7 %
Total	173	100.0

Tabela 4. Shpërndarja e pyetësorit për koordinatorët e konsultimit publik sipas institucioneve:

INSTITUCIONI	FREKUENCA	PËRQINDJE
Pushteti qendror	9	50.0
Pushteti vendor	9	50.0
Total	18	100.0

Pyetësori për koordinatorët e informimit si dhe pyetësori për koordinatorët e konsultimit publik janë ndërtuar në katër seksionet e mëposhtme:

- pjesa e parë, të dhëna të formimit të përgjithshëm dhe informacion demografik për të intervistuarin;
- pjesa e dytë , aspekti ligjor /institucional;
- pjesa e tretë, aspekti organizativ/ infrastruktura;
- pjesa e katërt, aspekti individual

Për analizën e të dhënave të mbledhura me anë të pyetësorëve është përdorur Paketa Statistike për Shkencat Sociale (SPSS version 20.0). Duke marrë parasysh se të dhënat e përpunuara janë kryesisht kategorike, paketa e zgjedhur SPSS konsiderohet ideale për përpunimin e të dhënave dhe analizën e tyre.

Një nga elementët për të rritur nivelin e saktësisë së të dhënave të marra në studim është matja e shkallës së mospërgjigjes së sondazhit. Më poshtë, po paraqesim formulën për të llogaritur madhësinë e mospërgjigjes së sondazhit.

$$\begin{aligned} \text{Shkalla e mospërgjigjes(\%)} &= 100 - \frac{\text{intervista te plotesuara}}{\text{kampioni fillestar}} * 100 \\ &= 100 - \frac{137}{173} * 100 = 20.81\% \end{aligned}$$

Nëse do të analizojmë shkallën e mospërgjegjjes sipas institucioneve do të kishim këto të dhëna:

Tabela 5. Shkalla e mospërgjegjjes sipas institucioneve

INSTITUCIONI	FREKUENCA
Pushteti qendror	20.8
Pushteti vendor	19.7
Institucionet e pavarura	25.0
Drejtoritë e Përgjithshme	20.0
Total	86.3

Duket se kemi një shpërndarje të njëjtë të mospërgjegjjeve kundrejt institucioneve që morën pjesë në sondazh. Studimet në lidhje me shkallën e mospërgjegjjes në kërkimet sociale sugjerojnë se një shkallë përgjegjje prej 50% konsiderohet si e përshtatshme për analizimin dhe raportimin e të dhënave të ndryshme. Një shkallë përgjegjje prej 60% është e mirë, ndërsa një shkallë përgjegjje më shumë se 70% është shumë e mirë për të analizuar të dhënat e marra.

Shkalla e përgjegjjes në vrojtimin e koordinatorëve të informimit është 79.19 %, e cila konsiderohet një shkallë përgjegjje e lartë që lejon që të dhënat e marra nga të intervistuarit të ndikojnë në përfundimet e arritura për koordinatorët e informimit.

V. ASPEKTI LIGJOR / INSTITUCIONAL

Gjetje paraprake

Koordinatorët e të drejtës për informim, por edhe ata të njoftimit dhe konsultimit publik nuk kanë një status të veçantë brenda institucionit, për sa i përket:

- 1. Pozicionit hierarkik brenda strukturës së institucionit.** Nga monitorimet është konstatuar se shpesh koordinatorë caktohen specialistë të drejtorive juridike apo të burimeve njerëzore, të cilët nuk gëzojnë “pushtetin” e duhur për të “detyruar” administratën e institucionit apo dhe eporët e tyre për kthimin e përgjigjeve dhe realizimin e proceseve konsultuese për çdo projekt-akt. Në shumë situata kjo çon në anashkalimin e koordinatorit gjatë zbatimit të ligjit “Për të drejtën e informimit” dhe “Për njoftimin dhe konsultimin publik”. Roli i tyre bashkërendues ndërmjet hallkave të ndryshme të institucionit, përgjegjësia e tyre për të garantuar këto të drejta dikton nevojën që koordinatorët të kenë një nivel të caktuar hierarkik brenda institucionit për të realizuar detyrat e tyre brenda afateve ligjore. Kjo edhe për faktin se në rastin e së drejtës për informim, caktimi si koordinatorë të nëpunësve të niveleve të ulëta nuk është në proporcion me përgjegjësitë direkte administrative që ligji i ngarkon atyre në rastin e shkeljeve administrative.
- 2. Mënyrës dhe kritereve të caktimit të koordinatorit.** Ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe ligji nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik” nuk përcaktojnë kritere të përzgjedhjes së koordinatorëve, por vetëm detyrimin e organit publik për caktimin si koordinator të një prej nëpunësve të tij⁹. Në disa raste, ky rol i caktohet pozicioneve politike, si këshilltar i ministrit, të cilët nuk garantojnë qëndrueshmërinë e këtij roli dhe nuk i korrespondojnë funksioneve dhe detyrave të koordinatorit. Gjithashtu, shpesh, duke qenë nëpunës të cilët mbajnë pozicione të natyrave jo të lidhura me këto fusha, ata nuk zotërojnë njohuritë dhe ekspertizën e nevojshme për një funksion kaq të rëndësishëm dhe kompleks. Parashikimi i kritereve ligjore për përzgjedhjen e koordinatorëve do të sigurojë qëndrueshmëri në detyrë, specializim dhe profesionalizëm më të lartë të koordinatorëve.
- 3. Trajtimit financiar dhe kohës së nevojshme për realizimin e detyrës së koordinatorit.** Koordinatorët nuk gëzojnë një trajtim të veçantë financiar dhe as burimet, përfshirë kohën e nevojshme, për të realizuar detyrat e tyre. Kjo e bën këtë “detyrë shtesë” një barrë për koordinatorët, të cilët duhet të realizojnë detyrat e shumta që ngarkon ligji përveç detyrave të tyre në pozicionin që ata mbajnë. Përveç kësaj, roli si koordinator nuk pasqyrohet në përshkrimin e tyre të punës që do t’u mundësonte atyre më shumë kohë në dispozicion dhe do të ndihmonte për një vlerësim të performancës së tyre. Edhe pse ligji e parashikon figurën e koordinatorit, vetë institucionet e kanë lënë të parregulluar pozicionin e koordinatorit, çka e vështirëson punën e tij/saj në praktikë.


9. Ligji nr. 146/2014, neni 10 thotë “një person” dhe jo një prej nëpunësve civilë të institucionit.

Koordinatori për të drejtën e informimit

Gjetjet e vlerësimit bazuar në rezultatet e sondazhit


Nga sondazhi i kryer u konstatua se, edhe pse ligji parashikon se koordinatori për të drejtën e informimit caktohet një prej nëpunësve civilë të institucionit, **vetëm 64.2 % e tyre ishin nëpunës civil**. Kjo vihet re më shumë në pushtetin vendor ku më shumë se gjysma e koordinatorëve për të drejtën e informimit nuk janë nëpunës civilë, por edhe në institucionet e tjera si p.sh institucionet e pushtetit qendror apo institucionet e pavaruara jo të gjithë koordinatorët janë nëpunës civilë.

Statusi i koordinatorit




Nga analiza e të dhënave, vetëm për koordinatorët që janë nëpunës civil, konstatohet se **71.6% prej tyre janë specialist** ose shef sektori (50% janë në nivel specialisti dhe 21.6 % shef sektori) dhe vetëm 17% janë drejtor drejtorie dhe 11.4 % janë drejtorë të përgjithshëm.

Koordinator me statusin e nëpunësit civil



Mungesa e kriterëve të duhura në caktimin e koordinatorit vërehet edhe sa i përket profilit të tyre arsimor, ku nga sondazhi u vu re se vetëm **43% e të anketuarve kanë formim në fushën juridike**, ndërsa 39.4 %, në fushat informatike dhe shkenca politike, dhe pjesa tjetër në shkenca shoqërore.

Profili arsimor i koordinatorëve



Sa i përket përvojës së punës në institucion, shumica e tyre janë të rinj në institucion. Më konkretisht:

- **54 % janë relativisht të rinj në institucion nga 0-5 vjet,**
- 12.6 % janë shumë të rinj në institucion nga 0-1 vit, dhe
- vetëm 21.2% kanë një përvojë nga 5-10 vjet në institucion.

Përveç kësaj, përvoja e tyre si koordinator për të drejtën e informimit për 42.3 % të tyre është vetëm 1-2 vjet, 24.8 % shumë të rinj në detyrë nga 0-1 vit dhe vetëm **32.8 % kanë më shumë se dy vite përvojë si koordinator.**

Sa i përket përshtatshmërisë së detyrës së koordinatorit me këtë rol, **vetëm 16.8 % ishin pjesë e drejtorisë juridike**, ndërsa 19.7 % pjesë e drejtorisë për marrëdhënien me publikun, të tjerët ishin pjesë e kabinetit, drejtorisë së buxhetit dhe financës, e të tjera struktura të ngjashme me to.

Në lidhje me angazhimin e tyre në përditësimin e programit institucional të transparencës, **vetëm 65% janë shumë të angazhuar në përditësimin e këtij programi**, ndërsa 35.1 % janë aspak ose pak të angazhuar.

Koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik

Gjetjet e vlerësimit bazuar në rezultatet e sondazhit


Nga sondazhi i kryer u konstatua se **numri total i koordinatorëve për njoftimin dhe konsultimin publik ishte vetëm 18** për pushtetin qendror dhe vendor së bashku, ku 9 ishin nga pushteti qendror dhe 9 nga pushteti vendor.

Nga sondazhi i kryer u konstatua se **72.2 % e tyre ishin nëpunës civil**, 22.2% jo nëpunës civilë dhe 5.6 % staf politik.

Nga koordinatorët, të cilët janë nëpunës civil, vihet re se **69.3 % janë specialist ose shef sektori** (38.5 % janë në nivel specialisti dhe 30.8% shef sektori) dhe 30.7% janë sekretarë të përgjithshëm.


Me poshtë jepet shpërndarja e koordinatorëve sipas statusit të tyre në institucion.

Statusi i Koordinatorit në institucion



Lidhur me formimin e tyre arsimor, vetëm **44.4% e të anketuarve kanë formim në fushën juridike**, 22.2% në shkenca ekonomike dhe pjesa tjetër në shkenca shoqërore.

Profili arsimor i koordinatorëve



Sa i përket përvojës së punës në institucion shumica e tyre, **50 % janë relativisht të rinj në institucion 0-5 vjet**, 27.8 % janë shumë të rinj në institucion nga 0-1 vit dhe vetëm 16.7 % kanë një përvojë nga 5-10 vjet në institucion. Vetëm 5.6 % kanë përvojë pune më shumë se 10 vjet në institucion.

Ndërsa përvoja e tyre si koordinator për njoftimin dhe konsultimin publik varion:

- 33.3 % nga 1-2 vjet,
- 61% shumë të rinj në këtë pozicion nga 0-1 vit, dhe
- vetëm 5.6 % më shumë se dy vjet.

Sa i përket përshtatshmërisë së detyrës së koordinatorit me këtë rol, **vetëm 27.8 % ishin pjesë e drejtorisë juridike**, ndërsa 33.3 % pjesë e kabinetit dhe pjesa tjetër pjesë e drejtorisë së buxhetit dhe financës.

Vetëm 38.9 % u shprehen se janë shumë të angazhuar në realizimin e detyrimeve të institucionit bazuar në ligjin "Për njoftimin dhe konsultimin publik", **ndërsa 61.1%** u shprehen se nuk janë aspak apo pak të angazhuar.

Shumica e tyre, 72 % ishin njëkohësisht edhe koordinatorë për të drejtën e informimit.

ANALIZË PËRMBLEDHËSE E ASPEKTIT LIGJOR

Duke patur parasysh se shumica e koordinatorëve për të drejtën e informimit, por edhe ata të njoftimit dhe konsultimit publik janë nëpunës civil dhe janë specialistë, çka tregon se caktimi i tyre është bërë thjesht formalisht, duke i bërë ata joefikasë në ushtrimin e detyrave të tyre është e domosdoshme që një nga kriteret e përzgjedhjes dhe caktimit të koordinatorit të jetë pozicioni i tij i lartë brenda hierarkisë së institucionit. Nëpunësit civilë që caktohen të mbajnë rolin e koordinatorit sugjerohet të kenë një përvojë pune të paktën mbi 5 vite në institucion, për shkak të kompleksitetit të detyrave të tij. Ky duhet të jetë një nga kriteret e përzgjedhjes së tyre. Gjithashtu, roli i koordinatorit duhet të ketë qëndrueshmëri pasi kjo forcon kualifikimin dhe specializimin e tyre dhe rrit efikasitetin e burimeve të përdorura për trajnimin e tyre.

Vlerësohet se koordinatorët duhet të kenë formim arsimor ligjor, ose marrëdhënie me publikun, si fusha të përshtatshme me këtë detyrë. Kjo edhe pasi këto dy ligje të reja janë komplekse dhe kërkojnë njohuri specifike dhe të thella nga ana e koordinatorit.

Është e rëndësishme që koordinatori të përfshihet në realizimin e të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga ligji "Për të drejtën e informimit" duke qenë se ai është personi kyç për garantimin e zbatimit të këtij ligji. Ai duhet të jetë pika kyçe e institucionit për të gjitha çështjet e transparencës dhe dhënien e informacionit me karakter publik.

Në rastin e njoftimit dhe konsultimit publik nevojitet që organet publike në përputhje me ligjin përkatës të caktojnë koordinatorët sa më shpejt pasi kjo rrezikon seriozisht zbatimin dhe mbarëvajtjen e procesit të njoftimit dhe konsultimit publik sipas standardeve të parashikuara nga ligji. Ligji nuk e parashikon shprehimisht që duhet të jetë nëpunës civil, ndaj nevojitet ndryshimi i tij në këtë aspekt dhe mandej nevojitet që institucionet publike të respektojnë ligjin.

Koordinatori duhet të përfshihet në realizimin e të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga ligji "Për njoftimin dhe konsultimin publik" duke qenë se ai është personi kyç për garantimin e zbatimit të këtij ligji. Edhe pse ligji ia ngarkon detyrimet dhe përgjegjësitë që rrjedhin nga ky ligj "organit publik" si një i tërë, pa specifikuar ndarjen e përgjegjësisë brenda tij dhe i vetmi detyrim që ligji i ngarkon shprehimisht koordinatorit është ai i grumbullimit të komenteve dhe rekomandimeve të marra gjatë procesit të konsultimit në mënyrë të strukturuar dhe transparente (neni 19, pika 1), ligji duhet interpretuar sipas frymës së tij ku koordinatori siguron bashkërendimin e punës për zbatimin e tij. Ndërkohë edhe VKM Nr. 584, datë 28.08.2003 "Për miratimin e rregullores së Këshillit të Ministrave", i ndryshuar në Kreun III "Përgatitja e projektaktit" parashikon se çdo organ duhet të caktojë një punonjës të administratës, përgjegjës për hedhjen e të dhënave në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike të projektakteve, por pa iu referuar specifikisht koordinatorit për njoftimin dhe konsultimin publik. Është e nevojshme që organet publike t'ia ngarkojnë këtë detyrë koordinatorit të njoftimit dhe konsultimit publik në bazë të këtij vendimi si dhe kompetencat kryesore duhet të përfshihen në përshkrimin e tij të punës.

Kjo sjell nevojën e miratimit të rregullave/ udhëzimeve të brendshme të institucionit për të përcaktuar detyrat specifike të koordinatorit, titullarit dhe nëpunësve të tjerë të institucionit, por dhe detyrimet që ata kanë për të bashkëpunuar me koordinatorin në realizimin e funksioneve të tij për bashkërendimin e procesit të njoftimit dhe konsultimit publik të projektakteve dhe politikave me interes të lartë publik. Gjithashtu, është shumë e nevojshme që të shtohet një nen në këtë ligj, i cili të përcaktojë detyrat konkrete të koordinatorit në kuadër të detyrimeve që burojnë nga ky ligj si, edhe nevoja për hartimin e komenteve/udhëzuesve analizues në ndihmë të koordinatorëve të njoftimit dhe konsultimit publik.

VI. ASPEKTI ORGANIZATIV

Gjetje paraprake

Nga monitorimet janë konstatuar se koordinatorëve të së drejtës së informimit dhe të njoftimit dhe konsultimit publik **u mungon mbështetja e duhur organizative- institucionale** në aspektet e mëposhtme:

1. **Nuk ka akte të brendshme institucionale**, si rregullore të brendshme të institucionit, urdhra të brendshëm, përshkrim i punës së koordinatorit, të cilat shërbejnë si bazë ligjore për të siguruar akses dhe “pushtet” koordinatorëve tek drejtuesit e lartë dhe strukturat përkatëse të institucionit (përfshirë detyrimin e këtyre të fundit për të bashkëpunuar).
2. **Mungojnë udhëzues të brendshëm** të cilët bazuar në parashikimet dhe detyrat që ngarkon ligji, të zbërthejnë në hapa/procese konkrete realizimin e detyrave të koordinatorit, duke përcaktuar në mënyrë të qartë detyrat dhe përgjegjësitë e tij (përfshirë ndarjen e qartë të detyrave dhe përgjegjësi ndërmjet tij, titullarit, dhe nëpunësve të tjerë të institucionit). Gjithashtu, këto procedura duhet të rregullojnë organizimin e brendshëm të punës për kalimin e çdo kërkesë për informacion tek koordinatori për ta trajtuar atë me efikasitet dhe cilësi. E njëjta gjë duhet të ndodhë edhe për procesin e njoftimit dhe konsultimit publik me palët e interesuara për çdo akt apo politikë me interes publik që hartohet nga autoriteti publik. Kjo duhet të shoqërohet me masa informuese në institucion lidhur me koordinatorin dhe rolin e tij brenda institucionit.
3. **Nuk ka procedura të brendshme të institucionit lidhur me koordinimin me degët territoriale** për zbatimin e ligjit “Për të drejtën e informimit”. Këto procedura duhet të përfshijnë detyrimin që ka titullari i drejtorive rajonale për të komunikuar dhe bashkëpunuar me koordinatorin, i cili në bazë të ligjit është përgjegjës për trajtimin e kërkesave që paraqiten në degët e institucionit që konsiderohen si struktura në varësi të autoritetit publik.
4. **Mungesa e sistemeve të monitorimit dhe vlerësimit të performancës së koordinatorëve** (bazuar në objektiva pune konkrete dhe të matshëm).
5. **Mungesa e një rrjeti të koordinatorëve të së drejtës së informimit dhe njoftimit dhe konsultimit publik**, për unifikimin e praktikave/ modeleve pozitive dhe adresimin e problematikave të evidentuara gjatë zbatimit të këtyre ligjeve.


Koordinatori për të drejtën e informimit

Gjetjet e vlerësimit bazuar në rezultatet e sondazhit

Nga rezultatet e sondazhit vihet re se vetëm **40.1 % e institucioneve kanë procedura të shkruara** për marrëdhënien e koordinatorit me institucionin dhe **58.4 % nuk kanë**. Kjo vihet re si në pushtetin qendror ashtu edhe në pushtetin vendor, ku kjo mungesë është edhe më e theksuar. Gjithashtu, **vetëm 58.4 % u shprehën se drejtoritë e institucionit janë shumë bashkëpunuese** gjatë veprimtarisë së koordinatorit, ndërsa 37.2 % u shprehën se ato nuk janë aspak ose pak bashkëpunuese.

Vetëm 44.5 % kanë rolin e koordinatorit të përfshirë në përshkrimin e tyre të punës dhe për 97.1 % detyra si koordinator zë një pjesë të kohës së punës së tyre dhe vetëm **2.9 % janë koordinatorë me kohë të plotë**. Gjithashtu, **vetëm 58.4 % u shprehën se kanë kohë të mjaftueshme në dispozicion** për realizimin e detyrës së koordinatorit, ndërsa 39.4 % nuk kanë fare ose nuk kanë mjaftueshëm kohë dhe vetëm 2.2 % u shprehën se kanë shumë kohë në dispozicion.


Koha në dispozicion të koordinatorëve



Mungesa e rregullave të brendshme që rregullojnë qartë marrëdhënien e koordinatorit me pjesët e tjera të institucionit konfirmohet dhe nga diskutimet në fokus grupet e organizuara me përfaqësues të tjerë të institucionit jo në pozicionin e koordinatorëve. Gjithashtu, caktimi i rolit të koordinatorit nëpunësve në nivele të ulëta dhe mosrregullimi i këtij roli në përshkrimet e tyre të punës, konfirmohet edhe nga aksesit i ulët që ata kanë si tek nivelet e larta drejtuese/politike vendimmarrëse dhe tek strukturat e tjera të institucionit. Kështu:

- vetëm 51.5 % e të anketuarve u përgjigjën se kanë shumë akses tek nivelet e larta drejtuese të institucionit për të realizuar detyrën e koordinatorit, ndërsa
- **43% e tyre u shprehën se nuk kanë aspak ose pak akses** tek ta për realizimin e detyrave të tyre si koordinator, ndërkohë që
- 5.8% e koordinatorëve nuk kanë tentuar fare të kenë akses tek eprorët e tyre.

Aksesi



Vetëm 30.7% u shprehen se ka procedura të miratuara për komunikimin me degët rajonale të institucionit dhe vetëm 29% të tyre u shprehen si ky komunikim realizohet me anë të sistemit IT.

Nga ana tjetër, është e nevojshme që detyrimet ligjore të koordinatorit dhe institucionit në tërësi të zërthehen në **procedura operacionale specifike** të brendshme të institucioneve, që përcaktojnë qartë detyrat dhe përgjegjësitë e koordinatorit, organizimin e brendshëm të punës gjatë trajtimit të kërkesave për informacion dhe realizimit të detyrimeve që parashikon ligji. Kështu:

- **36.5 % deklaruan se nuk u janë ofruar udhëzime** që rrisin cilësinë e zbatimit të ligjit, ndërsa
- 24.1 % u janë ofruar udhëzime të tilla vetëm një herë,
- 27.7% më shumë se njëherë, dhe vetëm
- 11.7% kanë deklaruar që kanë marrë udhëzime periodike për ushtrimin e kompetencave të tyre.

Lidhur me asistencën e nevojshme nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, **42.3 % kërkojnë asistencë për trajtimin e rasteve specifike e komplekse, 35% kërkojnë asistencë ligjore** dhe trajnime, ndërsa 22.6% duan vetëm trajnime.

Përsa i takon ekzistencës së një sistemi monitorimi dhe vlerësimi të punës si koordinator bazuar në objektiva të performancës (me indikatorë përkatës), koordinatorët janë shprehur se:

- vetëm 29.9% e të anketuarve deklarojnë se funksionon një sistemi i tillë vlerësimi;
- **62.8% e tyre shprehen se nuk ka një sistem të tillë**, ndërsa
- 7.3 % nuk kanë informacion në lidhje me ekzistencën e një sistemi vlerësimi të tillë.

59 % e koordinatorëve të së drejtës së informimit deklarojnë se bëjnë raportime periodike tek titullari i institucionit lidhur me detyrën si koordinator, çdo tre muaj, 6 muaj apo një herë në vit, ndërsa 19 % shprehen që nuk raportojnë asnjëherë, dhe pjesa tjetër pothuajse 21.9 % e të anketuarave nuk janë përgjigjur kësaj pyetjeje.

Ndërkohë që **94.2 % shprehen se nuk kanë qenë ndonjëherë subjekt i procedurave disiplinore brenda institucionit** për detyrën e tyre si koordinator dhe vetëm 3.6 % një herë dhe 2.2 % me shumë se një herë. Kjo tregon një nivel të ulët të kontrollit dhe llogaridhënies së brendshme të koordinatorit duke pasur parasysh nivelin e ulët të treguesve të realizimit të detyrave të tyre. I vetmi mekanizëm është ai i ankimeve nga palët e interesuara për llogaridhënien e koordinatorëve pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Krijimi i një rrjeti të koordinatorëve vlerësohet si i nevojshëm nga ana e koordinatorëve, përkatësisht **91.2 % e tyre deklarojnë se një rrjet i tillë**, do të ndihmojë në shkëmbimin e përvojave, adresimin e problematikave, trajnimin e mëtejshëm dhe unifikimin e praktikave për çështje komplekse. Kjo u jep atyre mundësinë për të pasur akses në zhvillimet e fundit të legjislacionit dhe jurisprudencës në këtë fushë.

Koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik

Gjetjet e vlerësimit bazuar në rezultatet e sondazhit

Pyetjes se sa bashkëpunues janë drejtoritë e tjera të institucionit gjatë veprimtarisë së koordinatorit për njoftimin dhe konsultimin publik, koordinatorë i janë përgjigjur:


- 33.3% shprehen se drejtoritë e tjerë të institucionit janë shumë bashkëpunuese, ndërsa
- **61.1% deklarojnë se ato nuk janë aspak ose pak bashkëpunuese gjatë ushtrimit të detyrave si koordinator.**

55.6% e të anketuarave u shprehën se institucioni ka procedura të shkruara për marrëdhënien e koordinatorit me institucionin, ndërkohë që 44.4 % e tyre deklarojnë se nuk ka procedura të tilla të shkruara.

33.4 % e koordinatorëve të konsultimit publik u shprehën se në çdo rast apo në shumicën e rasteve detyra e tyre si koordinator u caktohet edhe nëpunësve të tjerë brenda institucionit, ndërsa 61.1 % e tyre deklarojnë se një gjë e tillë ndodh rrallë ose asnjëherë.

Përsa i takon informimit të punonjësve të tjerë të institucionit në lidhje me pozicionin dhe detyrën e koordinatorit të njoftimit dhe konsultimit publik, vetëm 61.1 % u shprehën se punonjësit e institucionit janë të informuar, ndërsa 38.9 % deklarojnë se ata nuk janë informuar. Nevojitet që institucionet të rrisin shkallën e ndërgjegjësimit brenda strukturave të tyre lidhur me rolin e koordinatorit për njoftimin e konsultimin publik, pasi kjo rrit bashkëpunimin dhe realizimin më me efikasitet të detyrave që atij i ngarkon ligji.


Ndërgjegjësimi në institucion lidhur me figurën e koordinatorit



Pyetjes nëse detyra e tyre si koordinator është **përfshirë në përshkrimin e tyre të punës, 50% e koordinatorëve i janë përgjigjur pozitivisht**. Për 94.4% e tyre detyra si koordinator zë një pjesë të kohës së punës dhe vetëm 5.6% (1 prej tyre) është koordinator me kohë të plotë.

Në lidhje me pyetjen nëse kanë apo jo **kohë të mjaftueshme në dispozicion** për realizimin e detyrës së koordinatorit **vetëm 44.44% e të anketuarve u shprehen se kanë kohë të mjaftueshme në dispozicion** për realizimin e detyrës së koordinatorit, ndërsa 55.6% nuk kanë fare dhe ose jo mjaftueshëm kohe.

Koha në dispozicion të koordinatorëve




Mungesa e rregullave të brendshme që rregullojnë qartë marrëdhënien e koordinatorit me strukturat e tjera të institucionit, caktimi i rolit të koordinatorit nëpunësve në niveleve të ulëta, dhe mosrregullimi i këtij roli në përshkrimet e tyre të punës, konfirmohet edhe nga **aksesi i ulët** që këta koordinatorë kanë si tek nivelet e larta drejtuese/politike vendimmarrëse të institucionit dhe pjesët e tjera të tij. Kjo gjetje u konfirmua dhe nga diskutimet që u zhvilluan me përfaqësues të tjerë të institucioneve në nivel qendror

dhe vendor jo në pozicionin e koordinatorit për njoftimin dhe konsultimit publik.

Kështu, nga pikëpamja sasiore, **vetëm 27.8% e të anketuarve u përgjigjën se kanë shumë akses tek nivelet e larta drejtuese** të institucionit për të realizuar detyrën e koordinatorit, ndërsa **55.6 % e tyre u shprehën se nuk kanë aspak ose pak akses** tek ta për realizimin e detyrave të tyre si koordinator.

Aksesi



Nga ana tjetër, është e nevojshme që detyrimet ligjore të koordinatorit dhe institucionit në tërësi të zbërthehen në **procedura operationale specifike** të brendshme të institucioneve, që përcaktojnë qartë detyrat dhe përgjegjësitë e koordinatorit, organizimin e brendshëm të punës gjatë realizimit të detyrimeve që parashikon ligji. Kështu **44.4 % deklaruan se nuk u janë ofruar udhëzime** që rrisin cilësinë e zbatimit të ligjit, ndërsa 44.4 % u janë ofruar udhëzime të tilla vetëm një herë, 11.1 % më shumë se një herë.

Ndërkohë 94.4% e koordinatorëve shprehen se nuk kanë qenë ndonjëherë subjekt i procedurave disiplinore brenda institucionit për detyrën e tyre si koordinator dhe vetëm 5.6 % kanë qenë një herë subjekt i procedurave disiplinore.

ANALIZË PËRMBLEDHËSE E ASPEKTIT ORGANIZATIV

Për të pasur një rol të mirëpërcaktuar të koordinatorit për të drejtën e informimit si dhe atij të njoftimit dhe konsultimit publik është e nevojshme që në rregulloren e brendshme të institucionit/ose me urdhër të brendshëm, të parashikohet roli i koordinatorit në kuadër të detyrimeve që parashikon ligji, të drejtat e tij brenda institucionit, që i sigurojnë atij aksesin e nevojshëm ndaj drejtuesve dhe strukturave përkatëse të institucionit, përfshirë detyrimin e këtyre të fundit për të bashkëpunuar. Në rastin e koordinatorit për të drejtën e informimit, duhet të ndryshohet ligji për të përcaktuar drejtë rastet kur koordinatori mban përgjegjësi administrative dhe rastet kur përgjegjësinë e ka nëpunësi civil, i cili ka penguar/nuk ka mundësuar dhënien e informacionit (neni 18, pika 2, shkronja l e ligjit duhet sqaruar).

Nevojitet që detyra e koordinatorit për të drejtën e informimit dhe atij të njoftimit dhe konsultimit publik, të përfshihet në përshkrimin e punës si dhe të bëhet një vlerësim i bazuar në të dhëna të institucionit se sa kohë i nevojitet realisht koordinatorit për të realizuar detyrat e tij sipas ligjit. Në rast të institucioneve më fluks të madh kërkesash për informim apo aktesh që duhet t'i nënshtrohen procesit të konsultimit publik me palët e interesuara duhet të caktohet një koordinator me kohë të plotë. Një gjë e tillë do të ndihmojë në zbatimin me cilësi dhe profesionalizëm të detyrimeve që rrjedhin nga ligji nr. 119/2014 dhe ligji nr. 146/2014.

Në rastin e institucioneve, të cilat kanë degë rajonale, nevojitet të miratohen rregulla të tilla për bashkëpunimin ndërmjet degëve rajonale dhe koordinatorit, duke përdorur mjetet e teknologjisë së informacionit, në veçanti duke pasur parasysh afatet ligjore dhe përgjegjësinë e koordinatorit, dhe realizimin e së drejtës për informim në kohë për qytetarët. Në bazë të Kodit të Procedurave Administrative vendi ku paraqitet kërkesa nuk ka rëndësi ligjore dhe afatet vazhdojnë të ecin sikur ajo të ishte paraqitur në nivel qendror. Këto procedura duhet të parashikojnë përgjegjësinë që ka titullari i degës territoriale për të komunikuar dhe bashkëpunuar me koordinatorin në respektim të afateve ligjore dhe cilësisë së informacionit të kërkuar.

Gjithashtu, institucionet duhet të hartojnë udhëzues të brendshëm që përmbajnë procedura operacionale specifike lidhur me kompetencat dhe përgjegjësitë e koordinatorëve të së drejtës së informimit dhe të njoftimit dhe konsultimit publik. Procedurat operacionale duhet të zbërthejnë në hapa/procese konkrete realizimin e detyrave të koordinatorëve, duke përcaktuar në mënyrë të qartë detyrat dhe përgjegjësitë e tyre si dhe hallkave të tjera të institucionit.

Një sistem i brendshëm institucional për vlerësimin e performancës së koordinatorëve, si pjesë e përshkrimit të tyre të punës, bazuar në objektiva dhe indikatorë është një instrument i nevojshëm, i cili mund të shoqërohet me raportime periodike të koordinatorit tek titullari i institucionit lidhur me gjendjen e transparencës, statistikat mbi kërkesat për informacion dhe ankimet ndaj institucionit tek Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Nevojitet që institucionet shtetërore të rrisin shkallën e ndërgjegjësimit brenda strukturave të veta lidhur me rolin e koordinatorit për njoftimin e konsultimin publik, pasi kjo rrit bashkëpunimin dhe realizimin e detyrave që atij i ngarkon ligji.

VII. ASPEKTI INDIVIDUAL

Gjetje paraprake

Nga monitorimet janë konstatuar se koordinatorët e së drejtës së informimit dhe njoftimit dhe konsultimit publik nuk kanë **ndërgjegjësimin e duhur** lidhur me detyrimet e ligjit dhe **u mungojnë kapacitetet profesionale** për të bashkërenduar punën brenda institucionit në aspektet e mëposhtme:

1. **Formimi arsimor.** Personat e caktuar në rolin e koordinatorit shpesh nuk kanë formim ligjor, që është profili i duhur për këtë detyrë. Kjo për faktin se e drejta e informimit duke qenë një e drejtë horizontale dhe e ndërlidhur me fusha të tjera të së drejtës, si mbrojtja e të dhënave personale, sekretit shtetëror, pronësia industriale, e drejta administrative, penale, interpretimi i zbatimit të saj në praktikë është një ushtrim kompleks. Koordinatori, si personi i dedikuar në institucion duhet të përfaqësojë ekspertizën e institucionit në këtë fushë dhe t'i vijë në ndihmë si drejtuesit të tij në realizimin e detyrimeve për transparencën ashtu edhe të këshillojë dhe orientojë publikun në kërkesat e tij për informacion. Koordinatori duhet të jetë në gjendje të dijë ku ta kërkojë informacionin dhe duhet të ketë aftësi të mira për të përmbledhur vendimin dhe parashtruar edhe arsyetimin ligjor të tij. Gjithashtu, procesi i njoftimit dhe konsultimit publik është kompleks dhe përfshin një sërë hapash të rëndësishëm që kërkojnë njohuri të duhura në fushën e ligjit dhe procesit të vendimmarrjes publike. Kjo e drejtë është e ndërvarur edhe me respektimin e së drejtës së informimit për realizimin e saj.
2. **Përvoja e duhur profesionale dhe organizative.** Roli i koordinatorit për të drejtën e informimit dhe njoftimit dhe konsultimit publik nuk kërkon vetëm njohuri të thella profesionale, por edhe njohje shumë të mirë nga ana e tij të vetë institucionit ku ai punon, strukturave të tij dhe gjithë administratës publike në përgjithësi. Për vetë nga natyra e përgjegjësiave koordinuese, ai duhet të jetë në gjendje të koordinojë komunikimin si me strukturat e brendshme të institucionit dhe me institucionet e tjera (si psh, në rastet e referimit të kërkesës për informim tek një institucion i dytë që disponon informacionin e kërkuar). Sigurisht, që ai mbështetet gjithmonë tek institucioni për të siguruar informacionin që i duhet, por kjo kërkon aftësi organizative shumë të mira.
3. **Mungesa e trajnimeve të vazhdueshme** për t'u specializuar në këtë fushë, përfshirë krijimin e një rrjeti të koordinatorëve që do të shërbente edhe si një platformë trajnuese për shkëmbimin e përvojave ndërmjet tyre. Kjo mungesë sjell problematika në punën e tyre sa i takon interpretimit të ligjeve, dhe të kuptuarit të saktë të detyrave konkrete të koordinatorit për të drejtën e informimit dhe njoftimit dhe konsultimit publik për të siguruar zbatimin e këtij kuadri ligjor.

Koordinatori për të drejtën e informimit


Gjetjet e vlerësimit bazuar në rezultatet e sondazhit

Vetëm **43% e të anketuarve kanë formim në fushën juridike**, ndërsa 39.4 %, në fushat informatike dhe shkenca politike dhe pjesa tjetër në shkenca shoqërore.

Sa i përket kapaciteteve profesionale ekzistuese të koordinatorëve, **77.4 % mendojnë se profili i tyre është i përshtatshëm për këtë pozicion, dhe shumica e tyre 78.6 % i vlerësojnë njohuritë e tyre mbi ligjin “Për të drejtën e informimit” si shumë të mira ose të mira**, dhe vetëm 12.4% e tyre shprehen se kanë njohuri të pakta ose nuk kanë njohuri fare mbi të. Vihet re se, megjithë bindjen e tyre, nga monitorimet e kryera mbi nivelin e zbatimit të ligjit në praktikë, njohuritë e koordinatorëve mbi ligjin nuk janë të mjaftueshme. Kjo nënkupton jo vetëm njohuritë teorike, por edhe aftësinë për ta interpretuar ligjin siç duhet në rastet e praktikës së përditshme. Gjithashtu, kjo është në kontradiktë logjike me pyetjen e mëposhtme ku vetëm 34.3 % deklarojnë se kanë përvojë dhe kualifikim në fushën e legjislacionit për të drejtën e informimit.

Ndërkohë vetëm 34.3% e të anketuarve shprehen se kanë përvojë dhe kualifikim në fushën e legjislacionit për të drejtën e informimit, 27 % në organizimin e sektorit publik dhe të institucionit të tyre dhe 19.7 % në të drejtën administrative dhe teknologji informacioni. Kjo tregon se vetëm një pjesë e vogël e tyre kanë njohur dhe kompetenca në legjislacionit për të drejtën e informimit, që e bën shumë të vështirë realizimin në praktikë dhe siç duhet të përgjegjësive të tyre dhe për rrjedhojë të rritjes së transparencës së institucionit.

Përvoja dhe kualifikimi i koordinatorëve



Sa i përket trajnimit të koordinatorëve për të drejtën e informimit:

- **35 % u shprehën se nuk janë trajnuar asnjëherë** në lidhje me njohje dhe zbatimin e ligjit “Për të drejtën e informimit”,
- 27 % janë trajnuar vetëm një herë,
- 29.2 % janë trajnuar më shumë se një herë, dhe
- vetëm **8.8 % prej tyre** u janë ofruar trajnime periodike për njohjen dhe zbatimin e këtij ligji.

Këto të dhëna vijnë si rezultat i mungesës së qëndrueshmërisë së koordinatorëve të caktuar në këtë detyrë.

Aspektet e paqarta të koordinatorëve të së drejtës së informimit

Nga sondazhi i kryer dhe fokus grupet e organizuara u evidentuan një sërë mangësish dhe vështirësish që koordinatorët e së drejtës së informimit kanë në lidhje me kuptimin, interpretimin dhe zbatimin e ligjit “Për të drejtën e informimit” dhe detyrave të tyre konkrete.

Konkretisht, ata janë shprehur se kanë vështirësi në zbatimin në praktikë të:

- rasteve të kufizimeve të së drejtës për informim,
- mjeteve për të detyruar strukturat e tjera të institucionit që të bashkëpunojnë për dhënien e informacionit;
- qartësimin e rolit të tyre brenda institucionit, detyrat specifike të koordinatorit, përfshirë nevojën për një manual praktik për punën e koordinatorit;
- komunikimin me institucionet e vartësisë;
- identifikimin e institucionit që ka informacionin e kërkuar;
- ndarjen e kërkesave për informacion nga kërkesat e tjera administrative të qytetarëve;
- menaxhimin e Regjistrisë të Kërkesave dhe Përgjigjeve;
- përditësimin e Programit të Transparencës;
- balancën ndërmjet të drejtës për informim dhe mbrojtjes së të dhënave personale si dhe
- mungesën e dijenisë për kërkesat e ardhura për informacion si rezultat i mosnjohimit nga strukturat përkatëse të institucionit

Koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik

Gjetjet e vlerësimit bazuar në rezultatet e sondazhit

Përsa i takon formimit të koordinatorëve të konsultimit publik, **44.4% e të anketuarve kanë formim në fushën juridike**. Nevojitet që koordinatorët të kenë formim arsimor ligjor, ose marrëdhënie me publikun, si fusha të përshtatshme më këtë rol. Kjo edhe pasi këto dy ligje të reja janë komplekse dhe kërkojnë njohuri specifike dhe të thella nga ana e koordinatorit. Koordinatori, si personi i dedikuar në institucion duhet të përfaqësojë ekspertizën e institucionit në këtë fushë dhe t’i vijë në ndihmë si drejtuesit të tij në realizimin e detyrimeve për një proces të hapur, demokratik dhe cilësor të konsultimit me palët e interesuara në procesin politikbërës dhe vendimmarrës.

Sa i përket kapaciteteve profesionale ekzistuese të koordinatorëve:


- **83.3 %** e tyre mendojnë se profili i tyre është i përshtatshëm për këtë pozicion, dhe **shumica e tyre i vlerësojnë njohuritë e tyre mbi ligjin “Për njoftimin dhe konsultimin publik” si shumë të mira ose të mira, dhe**
- **vetëm 16.7 %** e tyre shprehen se kanë njohuri të pakta.

Ky rezultat bie në kontradiktë me rezultatet e përgjigjeve që koordinatorët kanë dhënë për përvojën dhe kualifikimin që ata kanë në fusha të ndryshme. Pavarësisht, bindjes që ata kanë për njohuri të thella në legjisllacionin për konsultimin publik:

- **vetëm 50 % e tyre shprehen se kanë përvojë dhe kualifikim** në këtë fushë,
- 27.8 % në procesin e vendimmarrjes së organeve publike, dhe
- të tjerë në të drejtën administrative, IT etj.

Kjo tregon se vetëm gjysma e tyre kanë njohuri dhe kompetenca në legjisllacionin për njoftimin dhe konsultimin publik, që e bën të vështirë realizimin në praktikë dhe siç duhet të detyrave të tyre dhe për rrjedhojë të zbatimit të procesit të njoftimit dhe konsultimit publik të institucionit me grupet e interesit.

Përvoja dhe kualifikimi i koordinatorëve



61.1 % e tyre u shprehën se nuk janë trajnuar asnjëherë në lidhje me njohjen dhe zbatimin e ligjit “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, **27.8 %** janë trajnuar vetëm një here, dhe vetëm 11.1% janë trajnuar

më shumë se njëherë. Këto të dhëna vijnë si rezultat i mungesës së qëndrueshmërisë së koordinatorëve të caktuar në këtë detyrë.

Koordinatorët e njoftimit dhe konsultimit publik kanë shumë aspekte të paqarta lidhur me mënyrën se si duhet të funksionojë roli i tyre brenda institucionit, detyrat dhe përgjegjësitë lidhur me zbatimin e ligjit “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, kategorizimin e dokumenteve të administratës publike, procedurat e mbledhjes së informacionit nga drejtoritë si dhe identifikimin e akteve të cilat përfshihen në grupimin e politikave me interes të lartë publik.

ANALIZË PËRMBLEDHËSE E ASPEKTIT INDIVIDUAL

Duke qenë se e drejta e informimit është një e drejtë horizontale dhe e ndërlidhur me fusha të tjera të së drejtës, si mbrojtja e të dhënave personale, sekreti shtetëror, pronësia industriale, e drejta administrative, e penale etj, interpretimi i zbatimit të saj në praktikë është një ushtrim kompleks. Koordinatori, si personi i dedikuar në institucion duhet të përfaqësojë ekspertizën e institucionit në këtë fushë dhe t'i vijë në ndihmë si drejtuesit të tij në realizimin e detyrimeve për transparencën ashtu edhe të këshillojë dhe orientojë publikun në kërkesat e tij për informacion. Gjithashtu koordinatorët duhet t'i nënshtrohen trajnimeve periodike në fushën e lirisë së informacionit, por edhe në fusha të tjera të ligjit si e drejta administrative, mbrojtja e të dhënave personale, sekreti shtetëror, pronësia industriale, e drejta penale, etj. Nëse koordinatorët nuk e kuptojnë dhe interpretojnë drejt ligjin dhe zbatueshmërinë e tij në praktikë kjo rrezikon realizimin e së drejtës nga qytetarët dhe penalizimin e padrejtë të tyre për shkak të mungesës së aftësive profesionale të tyre.

Gjithashtu, dhe për koordinatorët e njoftimit dhe konsultimit publik nevojitet që përveç formimit të duhur arsimor dhe përvojës profesionale, duke pasur parasysh që ligji është relativisht i ri dhe zbatimi i tij në praktikë është shumë kompleks dhe i lidhur me pjesë të tjera të legjisllacionit. Koordinatorët duhet t'i nënshtrohen trajnimeve periodike në fushën e njoftimit dhe konsultimit publik, por edhe lirisë së informacionit, përfshirë trajnime edhe në fusha të tjera të ligjit si e drejta administrative.

VIII. REKOMANDIME

Aspekti ligjor

1. Ligji “Për njoftimin dhe konsultimin publik” vlerësohet se ka nevojë të ndryshohet dhe të përcaktojë qartë se cilat janë detyrat konkrete të koordinatorit dhe përgjegjësitë e tij dhe të aktorëve tjerë brenda institucionit.
2. Gjithashtu, vlerësohet e domosdoshme të përcaktohet institucioni përgjegjës për mbikqyrjen e zbatimit të ligjit “Për njoftimin dhe konsultimin publik”. Gjykojmë se një mungesë e tilla ka ndikuar në nivelin e ulët të njohjes dhe zbatimit të këtij ligji nga autoritetet publike. Kjo vërtetohet akoma dhe më shumë nëse e shikojmë në raport me ligjin “Për të drejtën e informimit”, i cili ka shënuar një progres zbatimi më të lartë si rrjedhojë krahas të tjerave dhe të funksionimit të mekanizmit mbikqyrës të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjes së të Dhënave Personale.
3. Ligji “Për të drejtën e informimit” duhet të rishikohet në mënyrë që të parashikojë qartë përgjegjësinë e nëpunësve publikë në rastet kur bëhen ata pengesë për mosdhënien e informacionit me karakter publik.
4. Nisur nga roli kyç që koordinatorët për të drejtën e informimit dhe për njoftimin dhe konsultimin publik kanë për të garantuar zbatimin me efikasitet të drejtës së informimit dhe pjesëmarrjes qytetare në proceset vendimmarrëse, funksionit të tyre bashkërendues me hallkat e ndryshme brenda institucionit, vlerësohet e domosdoshme parashikimi i kritereve të qarta për përzgjedhjen e tyre. Këto kritere duhet të përfshijnë veçanërisht:
 - caktimin e detyrës së koordinatorit një pozicioni relativisht të lartë në hierarkinë e administratës së autoriteteve publike. Në gjykimin tonë sugjerohet një pozicion jo më i ulët se niveli i drejtorit të drejtorisë;
 - vlerësohet se koordinatorët duhet të kenë formim arsimor ligjor ose marrëdhënie me publikun, si fusha të përshtatshme me këtë detyrë. Kjo edhe pasi këto dy ligje të reja janë komplekse dhe kërkojnë njohuri specifike dhe të thella nga ana e koordinatorëve;
 - përvojë pune të paktën mbi 5 vite në institucion, për shkak të kompleksitetit të detyrave të koordinatorit;
 - Parashikimi i kritereve ligjore për përzgjedhjen e koordinatorëve do të sigurojë qëndrueshmëri në detyrë, specializim dhe profesionalizëm më të lartë të koordinatorëve e rrjedhimisht një shkallë më të lartë të respektimit të ligjeve përkatëse.
5. Caktimi i koordinatorit sugjerohet të bëhet me akt të titullarit dhe sugjerohet që ata të kenë statusin e nëpunësit civil, gjë e cila do të kërkojë ndryshime në ligjet përkatëse.
6. Nisur nga ngarkesa e punës dhe fakti që detyra e koordinatorit nuk është një detyrë me kohë të

plotë pune, me synim për t'i motivuar në ushtrimin e kompetencave të tyre ligjore sugjerohet që koordinatorët e të drejtës së informimit dhe ato të njoftimit dhe konsultimit publik të kenë një stimul financiar për këtë detyrë.

7. Në rastin e njoftimit dhe konsultimit publik nevojitet që organet publike në përputhje me ligjin përkatës të caktojnë koordinatorët sa më shpejt pasi kjo rrezikon seriozisht zbatimin dhe mbarëvajtjen e procesit të njoftimit dhe konsultimit publik sipas standardeve të parashikuara nga ligji.
8. Rregullorja e brendshme e çdo institucioni shtetëror duhet të përcaktojë se koordinatori përveç detyrave që i parashikon ligji, ai/ajo mbështet institucionin si një i tërë në çdo veprimtari lidhur me zbatimin e këtyre ligjeve dhe është pikë kontakti për institucionin.

Aspekti organizativ/ infrastrukturor

1. Organet publike duhet të parashikojnë në Rregulloren e brendshme të funksionimit të tyre pozitën e koordinatorit, duke përfshirë aty detyrat dhe kompetencat e tij dhe marrëdhënien e tij me strukturat e tjera të institucionit duke parashikuar qartë detyrimin e tyre për të bashkëpunuar me të.
2. Detyra e koordinatorit duhet të pasqyrohet qartë në përshkrimin e tij të punës, duke specifikuar aty kohën që ai do t'ia dedikojë kësaj detyre në raport me detyrat e tjera. Gjithashtu, nevojitet të bëhet një vlerësim i bazuar në të dhëna të institucionit se sa kohë i nevojitet realisht koordinatorit për të realizuar detyrat e tij sipas ligjit. Në rast të institucioneve me fluks të madh kërkesash për informim apo aktesh që duhet t'i nënshtrohen procesit të konsultimit publik me palët e interesuara duhet të caktohet një koordinator me kohë të plotë. Një gjë e tillë do të ndihmojë në zbatimin me cilësi dhe profesionalizëm të detyrimeve që rrjedhin nga ligji nr. 119/2014 dhe ligji nr. 146/2014.
3. Çdo institucion që ka një degë rajonale për të cilën është përgjegjës koordinatori në nivel qendror, lidhur me të drejtën e informimit, shihet e nevojshme miratimi i rregullave konkrete për bashkëpunimin midis institucionit dhe degëve rajonale përmes shfrytëzimit të mjeteve të teknologjisë së informacionit.
4. Çdo institucion duhet të këtë udhëzues të brendshëm që zërthejnë në hapa/procese konkrete realizimin e detyrave në kuadër të këtyre ligjeve, dhe të informojë gjithë institucionin lidhur me figurën dhe përgjegjësitë e koordinatorit. Ato gjithashtu duhet të hartojnë procedura operacionale specifike, përfshirë ato të marrjes dhe dërgimit të korrespondencës, në mënyrë që koordinatori të jetë i përfshirë në kohë në trajtimin e kërkesave për informim apo mbarëvajtjen e procesit të njoftimit dhe konsultimit publik.
5. Çdo institucion duhet të krijojë një sistem të brendshëm institucional për menaxhimin e performancës së koordinatorëve, si pjesë e përshkrimit të tyre të punës, bazuar në objektiva dhe indikatorë matës. Raportime periodike të koordinatorit tek titulli i institucionit lidhur me gjendjen e transparencës, dhe njoftimin dhe konsultimin publik duhet të jenë pjesë e menaxhimit të performancës së tyre.
6. Duhet të krijohet një rrjet i koordinatorëve për të drejtën e informimit dhe atyre për njoftimin dhe konsultimin publik për shkëmbimin e përvojave, modeleve pozitive si dhe unifikimin e praktikave për

çëshje komplekse. Një rrjet i tillë do të ndihmojë në forcimin e kapaciteteve dhe profesionalizmit të tyre.

Aspekti individual

1. Koordinatorët për të drejtën e informimit dhe ato për njoftimin dhe konsultimin publik është e rekomandueshme të kenë nivelin dhe profilin e duhur arsimor, në fushën e ligjit, marrëdhëniet me publikun dhe përvojë të mjaftueshme në këtë fushë.
2. Koordinatorët duhet t'i nënshtrohen trajnimeve në fushën e së drejtës së informimit dhe konsultimit publik, por edhe në të drejtën e mbrojtjes së të dhënave personale, të drejtën penale, tregtare, pronësinë industriale apo vendimmarrjen e organeve publike. Këto trajnime duhet të jenë të vazhdueshme dhe periodike.
3. Vlerësohet e rëndësishme njohja e këtij kuadri ligjor edhe nga titullarët e institucioneve dhe drejtuesit e strukturave të tjera dhe nëpunësit e administratës publike. Për këtë vlerësohet e rëndësishme që institucionet shtetërore të rrisin shkallën e ndërgjegjësimit brenda strukturave të veta lidhur me rolin e koordinatorit, pasi kjo rrit bashkëpunimin dhe realizmin e detyrave që atij i ngarkon ligji.

